

RAPORTIM PER PLANIN E VEPRIMIT PËR 5 PRIORITETET E KOMISIONIT EVROPIAN

HYRJJE

Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit lider për prioritetin 2 “Sistemi Gjyqësor”, prioritetin 3 “Lufta kundër korrupsionit”, si dhe institucion kontribues për prioritetin 5 “Mbrojtja e të drejtave të njeriut”, ka ndjekur dhe koordinuar punën më të gjithë aktorët lidhur me adresimin e rekomandimeve të progres raportit të Komisionit Evropian për vitin 2016.

Në mënyrë periodike ka vijuar përditësimi i Planin e Veprimit për 5 Prioritetet e Komisionit Evropian, për vitin 2017 dhe në vijim, monitorimi i rekomandimeve të Nënkomitetit të Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë, për të cilat Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse si dhe monitorimi dhe përditësimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017-2020 si dhe hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian për periudhën 2018-2020.

PRIORITETI 2

Sistemi gjyqësor

Në kuadër të plotësimit të masave “për të përforcuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore, parashikuar në prioritetin 2”, Ministria e Drejtësisë në cilësinë e institucionit përgjegjës ka ndjekur dhe koordinuar punën me të gjithë aktorët e përfshirë në proces. Në kuadër të *reformës në drejtësi janë miratuar 7 ligje prioritare* që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, të pushtetit gjyqësor, të prokurorisë, të strukturave të luftës kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit, ligjin e statusit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, ligjin për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në kuadër të *reformës në drejtësi* Kuvendi ka miratuar 15 ligje nga paketa e 27 projektligjeve të reformës në drejtësi, një pjesë e të cilave janë votuar me shumicë të cilësuar, si dhe ka vijuar punën për përgatitjen për miratim të 9 projektligjeve të tjera të kësaj pakete ligjore dhe tre projektligje janë tërhequr për tu përmirësuar¹.

Kuvendi ka miratuar *kodin e posaçëm për të mitur*, i hartuar sipas modelit më të mirë ndërkombëtar dhe që mundëson trajtimin e të miturve sipas standardeve ndërkombëtare.

Kodi i procedurës penale dhe kodi i procedurës civile u amenduan duke sjellë efikasitet dhe procedurë me të shpejta, efikasitet, shkurtim të kohëzgjatjes dhe numrit të seancave të proceseve civile; rritje e aksesit të qytetarëve të sistemi i drejtësisë. Ndryshimet në kodin e procedurës penale synojnë mbrojtjen më të mirë të viktimave në procesin penal, parashikimi i

¹ Projektligji “Për Presidentin e Republikës së Shqipërisë”; Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”; Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, i ndryshuar”

kartës së të drejtave të të pandehurve në proceset penale si dhe parashikohen disa institute të reja të cilat e bëjnë sistemin e drejtësisë më me pak kosto dhe më eficient për palët në proces.

Ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” u amendua në vitin 2017. Rrethi i subjekteve që deklarojnë u zgjerua me kandidatët për magjistratë dhe anëtarët e organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë u zgjerua. Ligji parashikoi ngritjen e sistemit që do të mundësojë deklarimin elektronik dhe përgatitjen e infrastrukturës për aksesin online të të dhënave që posedojnë institucionet nga Inspektoriati. Kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë nuk kryhet me short, por për të gjithë subjektet sipas afateve të përcaktuara në ligj, duke shkurtuar afatet periodike të kontrollit të deklaratave të funksionarëve të lartë.

Ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” u amendua në vitin 2017. Ndryshimet sollën zgjerimin e rrethit të krimeve për të cilat mund të konfiskohej pasuria, zbatimi i këtij ligji nga strukturat e reja të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, procedurat e sekuestrimit qartësohen, u shtuan sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive të barazvlefshme, revokimi i sekuestrimit.

Në vitin 2017, janë miratuar disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për Masat kundër Financimit të Terrorizmit”, në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, në ligjin Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, dhe ligjin “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”. Ndryshimet synojnë të harmonizojnë këto ligje me strukturat e reja të krijuara me Kushtetutë për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ndryshimet e miratuara në vitin 2017 në ligjin e përgjimeve të komunikimeve elektronike parashikojnë rregulla të detajuara për përgjimin, kohëzgjatjen, gjykatën kompetentë që miraton kërkesën për përgjim, revokimin e vendimit të përgjimit, rregullat e asgjësimit të materialeve të përgjimit, e drejta për informimin e shtetasve për përgjimin e tyre. Për herë të parë amendamentet përmirësojnë dukshëm procedurat e përgjimit dhe garantojnë mbrojtjen më të mirë të të drejtave të shtetasve.

Në datat 2 nëntor, Kuvendi i Shqipërisë miratoi përkatësisht ligjin nr.98/2017 “Për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” dhe në datë 18 dhjetor 2017 miratoi vendimin Nr.114/2017 “Për rrëzimin e dekretit nr. 10 656, datë 22.11.2017, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 98/2017 “Për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë””.

Në datë 14 dhjetor u miratua ligji Nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” i cili ka për qëllim: a) të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; b) të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike; c) të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive. Ligji hyn në fuqi më datë 01 Qershor 2018.

Aktualisht ngelen në proces, shqyrtimi i projektligjeve të reformës në drejtësi si vijon:

1. Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”;
2. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar”;
3. Projektligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.
4. Projektligji “Për Strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut në Republikën e Shqipërisë”;
5. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, ‘Për Avokaturën e Shtetit’;
6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”;
7. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar;
8. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”;
9. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;

Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë

Reforma në drejtësi ka sjellë ndryshime të rëndësishme në përcaktimet institucionale të gjyqësorit shqiptar. Institucionet ekzistuese janë modifikuar dhe institucione të reja janë krijuar nga amendamentet kushtetuese dhe ligjet specifike organike të lartpërmendura.

Referuar kompetencave të Ministrisë së Drejtësisë përsa i përket sistemit gjyqësor, informacioni është dhënë më sipër në pjesën e zhvillimeve ligjore të reformës në drejtësi. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” *nuk ushtron më kompetencën e kontrollit të veprimtarisë së prokurorive dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, për hetimin e shkeljeve disiplinore dhe të dhënies së rekomandimeve për procedim disiplinor në rastin e prokurorëve dhe procedimin disiplinor në rastin e gjyqtarëve.* Nga hyrja në fuqi e këtij ligji (22.11.2016), çdo ankesë apo informacion, që nga verifikimi paraprak rezulton se ka indicie të besueshme për shkelje të veprimtarisë nga ana e magjistratit, i përcillet për verifikim dhe ndjekje të mëtejshme të procedurave KLD-së apo/dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Institucionet e krijuara rishtazi janë si në vijim:

- Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016².
- Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.
- Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.
- Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar – Kushtetuta dhe ligji nr. 95/2016³.

²http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ligj_nr_115_2016_per_organet_e_qeverisjes_se_sistemit_te_drejtësisë_17_26.pdf

³<https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/10/ligj-nr-95-dt-6-10-2016.pdf>

- Njësia e Posaçme Hetimore/Byroja Kombëtare e Hetimit – Kushtetuta dhe ligji nr. 95/2016.
- Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar – Ligji nr. 95/2016.
- Këshilli Gjyqësor – Ligji nr. 98/2016⁴.
- Institucionet Ri-vlerësuese – Ligji nr. 84/2016⁵.

Zhvillimet kryesore për krijimin e institucioneve të reja janë si më poshtë:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është organ i pavarur që verifikon përmbushjen e kushteve ligjore dhe vlerëson kriteret profesionale e morale të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Përzgjidhet me short nga Presidenti i Republikës midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik dhe e fillon funksionimin në 1 janar të vitit pasardhës. Proçedura si rregull fillon që me datë 15 nëntor, si afati i fundit ku Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë verifikojnë nëse kandidatët për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi plotësojnë kushtet e parashikuara në ligj dhe i paraqesin Presidentit të Republikës dhe Kuvendit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet. Në kushtet kur nuk janë krijuar ende KLGJ dhe KLP, procedurat për përzgjedhjen e KED mund të ndiqen sipas dispozitave për përzgjedhjen e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve. Më datë 7 dhjetor 2017, Kryetari i Kuvendit ka hedhur shortin për KED, ku u zgjodhën 9 anëtarë, si dhe emrat e anëtarëve zëvendësues u shpallën në fund të proçesit. Nuk ka patur anëtar zëvendësues për Prokurorinë e Përgjithshme për shkak të mungesës së kandidaturave. Lajmërimi i rezultateve të shortit, si dhe raporti përkatës dhe minutat janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit të Shqipërisë. Lista e personave të përzgjedhur janë pjese e listes prioritare te subjekteve te rivleresimit. Komisioni i Pavarur të Kualifikimeve ka filluar procesin e rivlerësimit dhe pritet të përfundojë në javët në vijim.

Këshilli i Lartë Gjyqësor: Neni 147 i Kushtetutës parashikon që KLGJ është një organ kolegjal i përbërë nga 11 anëtarë nga të cilët gjashtë anëtarë zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë. Për të qenë pjesë e KLGJ, 14 gjyqtarë paraqitën kandidaturat e tyre, nga të cilët 2 nga Gjykata e Lartë, 3 nga gjykatat e apeleve si dhe 9 nga gjykatat e rretheve. Zgjedhja e gjyqtarëve kryhet nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve pasi gjyqtarët kandidat për anëtar të KLGJ t'i jenë nënshtruar procesit të vlerësimit kalimtar nga KPK.

Pesë anëtarët që zgjidhen nga Kuvendi, vijnë nga avokatia (2 anëtarë), nga akademia (2 anëtarë) dhe shoqëria civile 1 (anëtarë). Zgjedhja e gjyqtarëve kryhet nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve pasi gjyqtarët kandidat për anëtar të KLGJ t'i jenë nënshtruar procesit të vlerësimit kalimtar.

Procesi i përzgjedhjes së 5 anëtarëve nga radhët e juristëve jogjyqtarë për KLGJ tashmë ka përfunduar. Kuvendi ka miratuar me Vendimin nr. 18/2018 për zgjedhjen e anëtarëve të

⁴ http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/209-2016.pdf

⁵ <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/VETINGU/ligj-nr-84-dt-30-8-2016.pdf>

Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, kandidatët e listës së tretë në bllok. KLGJ krijohet kur anëtari i fundit zgjidhet nga autoritetet kompetente.

Pjesë e reformës ishte edhe **Gjykata e Lartë**, statusi dhe pozita e të cilës në sistemin gjyqësor ka ndryshuar. Sipas ndryshimeve kushtetuese, Gjykata e Lartë është tani një pjesë integrale e sistemit gjyqësor, si dhe është nën autoritetin e *Këshillit të Lartë Gjyqësor* përsa i përket karrierës dhe statusit të gjyqtarëve. Sipas kuadrit të ri kushtetues dhe ligjor, misioni ekzekutiv i Gjykatës së Lartë do të jetë shqyrtimi i çështjeve të cilat lidhen me kuptimin dhe zbatimin e ligjit, me qëllim që të sigurohet unifikimi, konsistenca dhe zhvillimi i jurisprudencës. Në këtë kuadër është krijuar një sistem i filtrimit të çështjeve që paraqiten në Gjykatën e Lartë, përmes vendosjes së shkaqeve rigoroze për ushtrimin e të drejtës së ankimit në Gjykatën e Lartë. Sipas këtyre shkaqeve, të cilat janë të unifikuara për të tre llojet e gjykimeve (civile, penale dhe administrative), në Gjykatën e Lartë mund të paraqiten çështje me rëndësi thelbësore për unifikimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e jurisprudencës, ose kur vendimi i kundërshtuar është i ndryshëm nga jurisprudenca e Kolegjeve të zakonshme ose ajo e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, në ligj janë përcaktuar kufijtë monetarë për vlerën e padive, nën të cilat ligji nuk lejon ushtrimin e rekursit në Gjykatën e Lartë. Tashmë roli i caktuar në Gjykatën e Lartë është ai i garantuesit të interpretimit uniform të ligjit dhe të mbrojtjes së të drejtave themelore të qytetarëve dhe jo i gjykatësit të shkallës së tretë. Gjykata e Lartë do të luajë këtë rol të rëndësishëm në administrimin e drejtësisë përmes unifikimit të jurisprudencës dhe zhvillimit të ligjit, duke garantuar konsistencën dhe koherencën e jurisprudencës me anë të uniformitetit të interpretimit ligjor, standardizimit të drejtësisë dhe respektimit të parimit të sigurisë juridike. Aktualisht GJL funksionon me 9 nga 17 anëtarë. Këto vakanca do të plotësohen pas krijimit dhe funksionimit të KLGJ. Aktualisht GJL ka në shqyrtim rreth 22.000 dosje.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë: Neni 149 i Kushtetutës parashikon që KLP është një organ kolegjal i përbërë nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë. Për të qenë pjesë e KLP-s, 19 prokurorë kanë paraqitur kandidaturat e tyre, nga të cilët 2 nga Prokuroria e Përgjithshme, 4 nga prokurorët pranë gjykatave të apelit, 2 nga prokuroria e krimeve të rënda si dhe 11 nga prokuroritë e rretheve. Zgjedhja e prokurorëve kryhet nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, pasi prokurorët kandidat të KLP t'i jenë nënshtruar procesit të vlerësimit kalimtar nga KPK

Pesë anëtarët që zgjidhen nga Kuvendi, vijnë nga avokatia (2 anëtarë), nga akademja (2 anëtarë) dhe shoqëria civile 1 (anëtarë). *Proçesi i përzgjedhjes së 5 anëtarëve jashtë komunitetit të prokurorëve për KLP ka përfunduar tashmë.* Kuvendi ka miratuar me Vendimin nr. 19/2018 për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Prokurorisë, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, kandidatët e listës së tretë në bllok. KLP krijohet kur anëtari i fundit zgjidhet nga autoritetet kompetente.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) është një organ kushtetues i cili është përgjegjës për vlerësimin e ankesave, fillimin e hetimeve lidhur me shkeljet dhe inicimin e procedurave disiplinore në lidhje me gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve, anëtarëve të KLGJ-së, anëtarëve të KLP-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Përveç kësaj, ILD është përgjegjëse për inspektimin institucional të gjykatave dhe prokurorive. Ai zgjidhet për një periudhë 9 vjeçare nga lista e 5 kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur në bazë të meritave nga Këshilli i Emërimeve të Drejtësisë, në përputhje të një procedure transparente dhe publike. Krijimi i Këshillit të Emërimeve të Drejtësisë së bashku me ekzekutimin e procesit të ri-vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, do të bëjë të mundur procedurat e përzgjedhjes së ILD-së.

Përzgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është e lidhur me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, si dhe me procesin e rivlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët (kur kandidatët vijnë nga kjo kategori). Në kushtet kur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk ka funksionuar dhe procesi i rivlerësimit sapo ka filluar, procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve kanë qenë të pezulluara.

Në Kuvend kanë paraqitur kërkesë për shprehje interesi dy kandidatë (magjistratë) të cilët do t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit me përparësi.

Ndërkohë, neni 282 i ligjit 115/2016 parashikon edhe se çdo jurist tjetër i interesuar për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i dorëzon aplikimin për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili kryen vlerësimin e kandidatëve, mbështetur edhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për aq sa është e mundur, për zbatimin e parashikimeve dhe procedurave të ligjit “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Progresi drejt ngritjes së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar/Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Njësisë së Posaçme Hetimore/Byroja Kombëtare e Hetimit

Në përputhje me dispozitat kushtetuese, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Njësia e Posaçme Hetimore/Byroja Kombëtare e Hetimit do të krijohen jo më vonë se 2 muaj nga themelimi i KLP. **Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duhet të krijohet jo më vonë se 2 muaj nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

Institucionet Ri-vlerësuese

Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Apelit, Komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë.

Kuvendi, me vendimin nr. 82/2017, ka miratuar listën në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në Vendimet nr. 92/2017, 93/2017 dhe 94/2017, Kuvendi ka miratuar strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit ("KA"), Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ("KPK") dhe Komisionerëve Publik ("KP").

Këshilli i Ministrave, me Vendimet nr. 518, datë 20.09.2017 dhe nr. 497, datë 13.09.2017 ka kaluar në përgjegjësi administrimi/përdorim të përkohshëm godinat ku do të ushtrojnë veprimtarinë organet e rivlerësimit kalimtar. Gjithashtu Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 574, datë 09.10.2017 ka përcaktuar pagesën mujore shtesë për shkak të vështirësisë, për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) po kryen procesin e hetimit administrativ për 93 subjekte dhe brenda muajit Mars do të fillojnë seancat e para dëgjimore publike.

PRIORITETI 3

Lufta kundër korrupsionit

➤ *Koordinatori Kombëtar në luftën kundër korrupsionit*

Bazuar në Vendimin Nr. 506, datë 13.09.2017 "Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë", Këshilli i Ministrave vendosi që Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, do të ketë rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

Në këtë kuadër pranë Ministrisë së Drejtësisë janë ngritur strukturat kundër korrupsionit, të cilat paraqiten si vijon: i) sektori i projektit antikorrupsion, pjesë e Drejtorisë së Konceptimit të Fizibilitetit dhe Projekteve, i cili ka në përbërje 3 nëpunës, të cilët do të kontribuojnë në zbatimin e projekteve antikorrupsion dhe do të koordinojnë aktivitetet për të siguruar progresin e dëshiruar për çdo projekt. ii) Drejtoria e Programeve në Fushën e Drejtësisë, e cila do shqyrtojë planin e veprimit të Strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2018-2020. Në këtë drejtori ka një sektor programesh në fushën e drejtësisë dhe antikorrupsionit, të përbërë nga 3 nëpunës. iii) Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë do të koordinojë të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit dhe planit të saj të veprimit. Kjo drejtori do të koordinojë dhe përgatisë raportimin në institucionet ndërkombëtare.

Dy përfaqësues nga Kabineti i Ministrisë janë caktuar për të ndjekur politikën kundër korrupsionit.

Referuar raportimeve të GREKO-s ju informojmë se **Raporti mbi raundin e 4 të vlerësimit** është publikuar në dt. 15.04.2016 nga ku 9 nga 10 rekomandime të GRECO janë vlerësuar "pjesërisht të zbatuara", ndërsa rekomandimi i 10-të u konsiderua "i zbatuar në mënyrë të kënaqshme". *MD duke filluar nga data 21 Dhjetor 2017 ka koordinuar mbledhjen e informacionit mbi zbatimin e 9 rekomandimeve të cilat kanë statusin e pjesësisht të zbatuara dhe është duke finalizuar përpunimin e informacionit përkatës.*

➤ Strategjia ndërsektorale kundër korrupsionit dhe plani i veprimit

Ministria e Drejtësisë ka finalizuar raportin e monitorimit për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit për vitin 2017 dhe paralelisht ka filluar punën për hartimin e planit të ri të veprimit për vitin 2018-2020.

Plani i Veprimit 2015-2017 përmban në total 191 masa, prej të cilave 143 masa me objektiv parandalimin, 26 masa me objektiv ndëshkimin e korrupsionit dhe 22 masa me karakter ndërjegjësues. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të raportimit për vitin 2017 rezulton se niveli i zbatimit të masave të planit të veprimit është si më poshtë:

Statusi i zbatimit	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit
Të zbatuara plotësisht	101	53%
Pjesërisht të zbatuara	61	32%
Të pa-zbatuara	14	7 %
Të pa-raportuara nga institucionet përgjegjëse	15	8%
TOTAL	191	100%

Në kuadrin e *qasjes parandaluese*, gjatë vitit 2017 shënohet një avancim në zbatimin e masave me karakter parandalues, përkatësisht një rritje me 8% krahasuar me nivelin e zbatueshmërinë së masave parandaluese gjatë vitit 2016.

Për sa i përket *qasjes ndërshkimore*, gjatë vitit 2017 shënohet një avancim në zbatimin e masave me karakter ndërshkimor, përkatësisht një rritje prej 8.8% krahasuar me zbatueshmërinë e masave ndërshkimore gjatë vitit 2016.

Ndërsa *qasja ndërjegjësuese* ka pësuar një rritje progresive në zbatimin e masave me karakter ndërjegjësues gjatë vitit 2017, përkatësisht një rritje prej 9.5% krahasuar me zbatueshmërinë e masave ndërjegjësuese gjatë vitit 2016.

Për sa i përket themelimit të *Strukturës së Posaçme Antikorrupsion (SPAK)*, Ligji Nr. 95/2016, "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*" konsiderohet si një nga elementet kryesorë të zhvillimeve legislative në fushën e luftës kundër korrupsionit. Procesi i ri-vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që po procedon në Shqipëri, do të shërbejë si bazë për krijimin e institucioneve të reja të lartpërmendura.

➤ Ndërgjegjësimi i opinionit mbi fenomenin e korrupsionit

Qeveria shqiptare ka lancuar në vitin 2015 portalin e www.stopkorrupsionit.al për të lejuar qytetarët që të parashtronin ankesa për shkeljet administrative, vonesat dhe praktikat korruptive që mund të kishin qenë dëshmitarë në administratën publike. Duke filluar nga viti

2015, në portalin antikorrupsion janë regjistruar 19,295 ankesa, nga të cilat 1,396 janë paraqitur si raste të korrupsionit. 119 raste janë përcjellë në prokurori, janë marrë 658 masa administrative dhe 71 masa disiplinore duke përfshirë shumë shkarkime. Ky portal tashmë është transferuar për administrim pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Së fundmi, Qeveria shqiptare ka zgjeruar fushëveprimin e mjeteve të saj të monitorimit dhe vlerësimit duke nisur një platformë më të gjerë për cilësinë e shërbimeve publike të ofruara si dhe reformat e ndërmarra: Platforma e bashkërendimit www.shqiperialigjeduam.al/ Kjo platformë lejon që çdo qytetar, shoqëri civile dhe grupi interesi jo vetëm të paraqesë një ankesë për një shërbim publik të caktuar, por edhe të parashtrojë ide dhe iniciativa të dobishme për komunitetin, kërkesë për seanca dëgjimore me zyrtarë qeveritarë, përfshirë ministrat dhe Kryeministrin për çështje specifike, propozime për përmirësimin e klimës së biznesit etj. Platforma menaxhohet nga një agjenci e sapokrijuar nën autoritetin e Kryeministrit, Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, e cila ka një rrjet të zyrtarëve shumë të trajnuar, të cilët janë të shpërndarë në administratë dhe funksionon si një njësi e reagimit të shpejtë për shërbimet publike. Që nga fillimi i saj në tetor 2017, platforma ka administruar më shumë se 3000 ankesa, nga të cilat 2200 janë adresuar plotësisht dhe më pas ka çuar në gati 40 shkarkime për shkelje dhe korrupsion. Platforma gjithashtu ka adresuar më shumë se 340 sugjerime të politikave dhe 2 seanca publike me zyrtarë të nivelit të lartë që çon në një përmirësim të efikasitetit në ministratë përkatëse.

➤ Kuadri ligjor

Ndër zhvillimet më të rëndësishme ligjore në luftën kundër korrupsionit janë hartimi, ndryshimi dhe miratimi i disa akteve ligjore të rëndësishëm si ligji për sinjalizuesit, K.Pr.Penale i ndryshuar, mbi partitë politike, për deklarimin dhe kontrollin e pasurive si dhe mbi përgjimin e komunikimeve elektronikë.

Në kuadër të luftës kundër korrupsionit, në vijim dhe të rekomandimeve të raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016 janë miratuar ligjet si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i cili ka përcaktuar rregullat për sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsionit nga sinjalizuesit në sektorin publik e privat, mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe detyrimet e autoriteteve publike e të subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.
- Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i cili ka për objekt të tij përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Njësisë së Pavarur Hetimore, si organe kushtetuese.
- Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;
- Ligji 90/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për Partitë Politike”, të ndryshuar. Nëpërmjet këtij ligji u përmirësuan rregullat për financimin e fushatës dhe të partive pjesëmarrëse në të, rritja e transparencës të shpërndarjes së fondeve publike për partitë politike duke shmangur mundësinë favorizimeve të padrejta partive politike nëpërmjet financimit publik. Në kuadër të masës për zhvillimin e modulit për hartimin e raporteve të KQZ-së, në muajin nëntor ka përfunduar dhe ndërtimi moduleve për pasqyrimin e raporteve të financave dhe dokumentacionit financiar nga partitë politike. Me datë 25 shtator 2017 përfundoi

afati i dorëzimit të raporteve financiare të partive politike, ku 7 parti politike kanë dorëzuar raportet financiare. Më datë 12 dhjetor 2017 u publikuan në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së⁶, raportet e monitorimit të fushatës zgjedhore dhe raportet e auditimit financiar.

- Ligjin nr. 42/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9049 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".

Në zbatim të ligjit 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", janë nxjerrë aktet nënligjore si vijon:

- Udhëzim i Inspektorit të Përgjithshëm nr. 1, datë 23.09.2016 "Për miratimin/përcaktimin e strukturës, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimin e punonjësve të njësisë përgjegjëse në subjektet private"
- Rregullore "Për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjen e konfidencialitetit në I.L.D.K.P.K.I"
- Rregullore "Për Hetimin Administrativ të Kërkesës së Sinjalizuesit për Mbrojtjen nga Hakmarrja në I.L.D.K.P.K.I".

Ndërkohë, ka përfunduar procesi i hartimit të të gjitha dokumenteve ndihmëse, siç janë formularët për sinjalizimin e brendshëm/jashtëm, kërkesën për mbrojtjen kundër hakmarrjes, regjistri i sinjalizimeve që do të mbahet nga njësitë përgjegjëse, udhëzimi për hartimin dhe miratimin e rregulloreve të brendshme nga njësitë përgjegjëse, si një bashkëpunim i ILDKPKI dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Për më tepër, ka përfunduar fushata e ndërgjegjësimit me përgatitjen dhe transmetimin e dy Spot-ve. TV Spot 1 ofroi informacion për ligjin, institucionet që janë të detyruara t'a zbatojnë atë, sanksionet në rast të mosrespektimit të udhëzimeve të ligjit, përfitimi që ligji sjell në luftën kundër korrupsionit, etj. TV Spot 2 ofroi informacion për punonjësit e institucioneve dhe publikun në përgjithësi mbi procedurat, format konkrete të sinjalizimit në institucione, çfarë duhet bërë në raste të tilla etj. Në kuadër të fushatës së ndërgjegjësimit u përgatitën dhe vendosën City Lights, Video në You Tube dhe në mediat sociale.

➤ Aksesi në bazat shtetërore të të dhënave

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për rritjen e shpejtësisë, cilësisë dhe efektivitetit në hetime aksesin në bazat shtetërore të të dhënave, nga institucioni i prokurorisë janë ndërmarrë hapa konkretë drejt bashkëpunimit me të gjitha institucionet kompetente, për të realizuar këtë objektiv. Prokuroria ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi në vitin 2016 me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për aksesin në sistemin e saj informatik, e konkretisht në Arkivin Kombëtar të Mjeteve dhe Regjistrin Kombëtar të Personave të Aftësuar për Drejtimin e Mjeteve. Në korrik 2017 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit për "Shkëmbimin e Informacionit Ndërmjet Sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes të Policisë së Shtetit dhe Sistemit të Menaxhimit të Çështjes së Prokurorisë", ndërsa në Gusht 2017 është rënë dakort në parim me Zyrën Qendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit "Për dhënien e të drejtës së aksesit prokurorisë në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme" dhe po procedohet më tej me reflektimin e teknikaliteteve.

⁶<http://www.cec.org.al/sq-al/Akte-t%C3%AB-KQZ-s%C3%AB/Aktet-e-KQZs%C3%AB/Vendimet/VENDIME-2017>.

➤ Të dhëna statistikore

- **Numri i rasteve të konfliktit të interesit për zyrtarët në ushtrim të funksioneve publike**

ILDKKPI në ushtrim të detyrave funksionale në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, mbi parandalimin e rasteve të konfliktit të interesave, si rrjedhojë e komunikimit të vazhdueshëm me Autoritetet Përgjegjëse, përgjatë periudhës **shtator 2016-dhjetor 2017** ka trajtuar dhe parandaluar **287 raste** të konfliktit të interesit për zyrtarët në ushtrim të funksioneve publike.

ILDKPKI gjatë ushtrimit të kontrolleve të plota të deklaratave të interesave private ka identifikuar rreth **112 raste** zyrtarësh që kanë ushtruar funksionet në kushtet e konfliktit të interesit, duke vendosur ndaj tyre masat administrative sanksion me gjobë.

- **Numri i rasteve të shkeljeve të konstatuara në deklaratat e interesave private**

✓ Numri i kallëzimeve penale në vite :

Për periudhën **2014 – 2017** , **262 kallëzime penale** janë referuar pranë zyrës së prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe strukturave të hetimit tatimor. **74 nga 262 kallëzime penale** kanë të bëjnë me vitin **2014**, për vitin **2015 janë paraqitur 84 kallëzime penale**, ndërsa për vitin **2016 janë 72 kallëzime penale**, ndërsa për vitin **2017 u paraqitën** pranë strukturave përkatëse 32 kallëzime penale. Këto referime përfshinë një numër të konsiderueshëm zyrtarësh të lartë, si anëtarë të parlamentit, gjyqtarë dhe prokurorë, ambasadorë, kryetarë bashkish, titullarë institucioneve qendrore dhe zyrtarë të tjerë. Vlen të theksohet se gjatë 2016-2017, janë 6 referime të kryera pranë organeve ligjzbatuese për Deputetë.

✓ Masat administrative në vite :

Për periudhën **2014 deri më shtator 2017**, ILDKPKI ka aplikuar rreth **1,700** sanksione administrative me "gjobë" për zyrtarët publik. Për vitin **2016**, janë aplikuar **314 masa** administrative me gjobë, ndërsa për periudhën janar– dhjetor 2017 ka aplikuar në total **438 masa** administrative me gjobë. Masat administrative të aplikuar nga ILDKPKI përfshijnë zyrtarë të lartë si ministra, zëvendësministra, deputetë, kryetarë të institucioneve etj.

- **Numri i rasteve të sinjalizimit dhe ndjekia e mëtejshme (mbrojtja)**

Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar krijimin e njësisë përgjegjëse brenda autoriteteve publike qendrore dhe vendore me mbi 80 punonjës dhe raportimin e tyre pranë ILDKPKI, me qëllim përpilimin e Regjistrit Kombëtar të njësisë përgjegjëse, së bashku me emrat dhe pozitën e personit përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, në total janë **163 njësi përgjegjëse** të ngritura në sektorin publik.

ILDKPKI ka marrë të gjitha masat për të siguruar krijimin e njësisë përgjegjëse brenda sektorit privat në organizatat me mbi 100 punonjës, me qëllim përpilimin e Regjistrit

Kombëtar të njësive përgjegjëse në sektorin privat, së bashku me emrat dhe pozitën e personit përgjegjës për zbatimin e këtij ligj, aktualisht janë **436 njësi përgjegjëse** të ngritura në këtë sektor.

Në përfundimit të këtij procesi, ILDKPKI për organizatat të cilat mbartnin detyrimin për ngritjen dhe raportimin e njësive përgjegjëse, por që nuk e përmbushën këtë detyrim brenda afateve ligjore të parashikuar nga ligji nr. 60/2016, vendosi masa administrative me gjobë për rreth 140 organizata.

Përgjatë periudhës së raportimit, ILDKPKI i ka kushtuar rëndësi të veçantë rritjes së kapaciteteve të personave të emëruar pranë njësive përgjegjëse, duke organizuar trajnime lidhur me njohjen e kuadrit ligjor mbi sinjalizimin, të drejtave dhe detyrimet e tyre në trajtimin e rasteve të sinjalizimit dhe sigurimin e mbrojtjes së sinjalizuesve. Gjithashtu, ILDKPKI ka ofruar këshillim të vazhdueshëm për çështje të parashtruara nga njësitë përgjegjëse si në sektorin publik dhe atë privat. ILDKPKI në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e saj ndërkombëtarë dhe ASPA përfundoi kurrikulën e Trajnimit të Trajnerëve, në bazë të të cilës u organizuan dy trajnime për të gjithë trajnerët e ASPA-së, në total 38 trajnere, të përfshirë në kurrikulat kundër korrupsionit gjatë muajit korrik 2017. Gjithashtu në muajin korrik 2017 u organizuan dy sesione trajnimesh për rreth 50 njësi përgjegjëse në sektorin publik në nivel qendror dhe vendor


➤ **Të dhëna statistikore të harmonizuara**

Referuar të dhënave statistikore për *veprat penale të korrupsionit për vitin 2017* krahasuar me vitin 2016 rezulton si më poshtë vijon:


- një rritje prej 22,6% e numrit të rasteve të regjistruara në prokurori në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 (2342 raste në vitin 2017 dhe 1910 raste në vitin 2016);
- një rritje prej 31,7% e numrit të rasteve të paraqitura në gjykate nga prokuroria në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 (813 raste në vitin 2017 dhe 617 raste në vitin 2016);
- për vitin 2017 nga Gjykatat e Shkallës së Parë janë shpallur të pafajshëm 135 persona dhe janë dënuar 570 persona, ndërkohë që nga Gjykatat e Apelit janë shpallur të pafajshëm 177 persona dhe janë dënuar 315 persona;
- Nga Gjykatat e Lartë për vitin 2017 janë shpallur të pafajshëm 10 persona dhe janë dënuar 16 persona;
- **Krahasuar me vitin 2016 Gjykatat e Shkallës së Parë kanë :**
 - një rënie në numrin e të dënuarve me 19% në vitin 2017;
 - një rënie në numrin e të pafajshmëve me 18% në vitin 2017; .
- **Krahasuar me vitin 2016 Gjykatat e Apelit kanë :**
 - një rritje në numrin e të dënuarve me 0.3% në vitin 2017;
 - një rritje në numrin e të pafajshmëve me 24% në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016.
- **Krahasuar me vitin 2016 Gjykata e Lartë ka :**
 - një rritje në numrin e të dënuarve me 700% në vitin 2017;
 - një rritje në numrin e të pafajshmëve me 67% në vitin 2017.

Në formë grafike do të gjeni të pasqyruar të dhënat e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit për vitet 2013-2017 lidhur me veprat penale të korrupsionit.

Gjykatat e Shkallë së Parë, vitet 2013-2017



Gjykatat e Apelit, vitet 2013-2017



PRIORIETETI 5

Mbrojtja e të drejtave të njeriut

Ministria e Drejtësisë në cilësinë e **institucionit kontribues** ka ndjekur dhe koordinuar punën me institucionet e saj të varësisë. *Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është lider për këtë prioritet.*

❖ E drejta e pronës

Referuar rristurimit të sistemit të menaxhimit të pronës në Shqipëri, për ta kthyer atë në një sistem modern, efikas dhe transparent në përputhje me praktikatat më të mira të vendeve të

tjera evropiane, Ministria e Drejtësisë ka vazhduar punën për implementimin e këtij procesi, i cili do të sjellë lehtësira në raport me zgjidhjen e shpejtë të problematikave dhe vonesave dhe shmangjes së sorollatjes në ndihmë të qytetarëve.

Përfundimi i Regjistrimit Fillestar

Procesi i regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme në Shqipëri ka filluar në vitin 1993 dhe vijon të kryhet edhe sot. Për administrimin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme territori i Republikës së Shqipërisë është ndarë në **3057 Zona Kadastrale**, nga të cilat:

- **2919 Zona Kadastrale Rurale**
- **138 Zona Kadastrale Urbane**

Zonat Kadastrale ku ka përfunduar regjistrimi fillestar

Procesi i regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme ka përfunduar në **2698 Zona Kadastrale**, nga të cilat:

- **2587 Zona Kadastrale Rurale**
- **111 Zona Kadastrale Urbane**

Numri i pasurive të paluajtshme të regjistruara në total është rreth 3.5 milion pasuri nga rreth 4 milion pasuri që është vlerësimi i numrit total të pasurive të paluajtshme në territorin e vendit.

ZK ku nuk ka përfunduar procesi i regjistrimit fillestar

Regjistrimi fillestar nuk ka përfunduar akoma në **359 ZK**, me rreth **500,000** pasuri të paluajtshme.

Plani për përfundimin e regjistrimit fillestar

Regjistrimi fillestar është në proces në 21 Zona Kadastrale me rreth 156,000 pasuri të paluajtshme. Faza e parë e procesit dhe afishimi public ka përfunduar në 12 zona kadastrale me rreth 81,296 pasuri të paluajtshme. Regjistrimi fillestar në vazhdim financohet nga të ardhurat e ZRPP.

Përditësimi dhe përmirësimi i të dhënave dixhitale

Të dhëna të plota dixhitale mbi pasuritë e paluajtshme, përfshirë Kartelën (informacion alphanumerik), Hartën Kadastrale dhe dokumentat ligjorë, janë të ngarkuara dhe të përditësuara në vazhdimësi në sistemin e kompjuterizuar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ALBSReP, vetëm për 126 zona kadastrale nga 2698 ku ka përfunduar regjistrimi fillestar. Për pjesën tjetër të zonave kadastrale, të dhëna të përditësuara të pasurive, përfshirë dhe hartën kadastrale, ekzistojnë vetëm në formë të printuar.

Zbatimi i Ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

- Akte nënligjore të dala në zbatim të Ligjit Ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”

Në zbatim të Ligjit nr.133/2015 gjatë vitit 2017 janë miratuar aktet e mëposhtme:

- Vendimi nr. 776, datë 22.12.2017 i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 223, datë 23.03.2016 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar dhe fizik për kompensim e pronave ", të ndryshuar;
- Vendimi nr. 765, datë 20.12.2017 i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin 222, datë 23.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin e kërkesave për njohjen e pronës dhe kompensimin e saj" i ndryshuar.

- Vlerësimi financiar të vendimeve që kanë njohur të drejtën për kompensim

Agjencia e Trajtimit të Pronave në zbatim të Ligjit nr. 133/ 2015 për “Trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 23.03.2016 për “Përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” (i ndryshuar), ka përfunduar procesin e vlerësimit ekonomik të vendimeve përfundimtare të viteve 1993, 1994 dhe 1995, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe i ka bërë publike ato në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare si dhe në faqen zyrtare Web të ATP-së www.atp.gov.al.

Nga përditësimin e këtyre të dhënave rezultojnë të vlerësuara 10 904 (41.8%) vendime, sic vijon:

- ✓ 409 vendime të dhëna gjatë vitit 1993;
- ✓ 3614 vendime të dhëna gjatë vitit 1994;
- ✓ 6881 vendime të dhëna gjatë vitit 1995;

Nga vlerësimi i këtyre vendime rezulton:

- ✓ Vlera financiare e 5640 vendimeve është 37 496 402 618 lekë
- ✓ 1261 vendime janë referuar nenit 7, pika 2, germa “a” të Ligjit nr.133 / 2015 dhe pikës 3, vendime të cilat konsiderohen të kompensuara.
- ✓ 4003 vendime që nuk u vlerësuan për arsye të ndryshme.

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka publikuar Regjistrin e vendimet për kompensim, ku evidenton në total 26 000 vendime për kompensim, 10 904 prej të cilave rezultojnë të vlerësuara.

- ✓ Kompensimi financiar dhe fizik

Kompensimi financiar

Ligji i ri parashikon se: “Subjektet e shpronësuara, të cilat disponojnë një vendim përfundimtar për kompensim, përfitojnë kompensim nga Fondi i Kompensimit në masën dhe sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj”. Kompensim financiar është kompensimi që kryhet

nga Buxheti i Shtetit për të gjithat vendimet që kanë njohur të drejtën për kompensim për zërin kadastral truall dhe gjithashtu për të gjithat aplikimet që bëhen me kërkesa të veçanta.

Përgjatë këtij viti Agjencia e Trajtimit të Pronave ka trajtuar me kompensim 1641 vendime (ku përfshihen 1261 vendime për të cilat subjektet konsiderohen të kompensuar në bazë të ligjit, 22 vendime për të cilat subjektet janë tërhequr nga procedimi administrativ gjatë fazës së shqyrtimit dhe 358 kanë përfituar kompensim financiar).

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka shpërndarë në total një fond financiar prej 3 764 828 608 lekë (1 805 417 553 lekë gjatë vitit 2016 dhe 1 959 411 055 lekë gjatë vitit 2017).

Kompensimi fizik

Agjencia e Trajtimit të Pronave disponon një fond toke i vënë në dispozicion nga shteti shqiptar dhe i regjistruar në ZRPP si tokë shtet në dispozicion të agjencisë; fond i cili përdoret për kompensim fizik.

Ligji nr.133/2015 parashikon se toka me zërat kadastral tokë bujqësore, pyll, livadh, kullotë kompensohen nga Fondi i Tokës.

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka shpërndarë për kompensim fizik nga Fondi i Tokës një sipërfaqe prej 323.4 ha, tokë bujqësore (65.9 Ha fond fizik i shpërndarë gjatë vitit 2016 dhe 257.5 ha fond fizik i shpërndarë gjatë vitit 2017), me një vlerë totale prej 663 222 108.36 lekë.

✓ Kompensimi me kërkesa të veçanta

Ligji i ri parashikon se fondet për kompensim me kërkesa të veçanta përbëhet nga 1/3 të buxhetit të shtetit për kompensim financiar. Procesi i kompensimit kryhet sipas rendit kronologjik të vendimmarrjes. Personat që aplikojnë për kompensim me kërkesë të veçantë, janë persona që nuk janë në rendin kronologjik të kompensimit, por duke hequr dorë nga një përqindje të kompensimit, përfitojnë kompensim financiar.

- ✚ Për kompensim brenda vitit, subjekti kërkues përfiton 20% nga vlera totale e kompensimit, duke hequr dorë nga pjesa tjetër.
- ✚ Për kompensim brenda 3 viteve, subjekti kërkues përfiton 30% të vlerës totale për kompensim.
- ✚ Për kompensim brenda 5 vjet subjekti kërkues përfiton 40% të vlerës totale për kompensim.
- ✚ Në këtë rast shteti i kursehet një vlerë të konsiderueshme të kompensimit.

Në bazë të nenit 17 të Ligjit nr.133 /2015, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer kompensim financiar për 16 aplikime për kërkesa të veçanta.

Vlera financiare totale që subjektet kanë përfituar nga kompensimin progresiv me kërkesa të veçanta është: 440 501 037 lekë.

Në total shteti iu detyrohet në bazë të aplikimeve (20 %, 30 %, 40%) 118 887 551 lekë, vlera financiare që këta subjekte do të përfitojnë.

Për aplikimet e mësipërme buxhetit të shtetit i kursehet një shumë prej 321 613 486 lekë.

✓ Trajtimi me vendim të kërkesave të subjekteve që kanë aplikuar për njohjen e pronës

Kërkesat të pa trajtuara përbëhen nga aplikimet, që pronarët të shpronësuar gjatë regjimit komunist, kanë depozituar pranë ATP për trajtimin e tyre me njohje për kthim / kompensim. Menjëherë pas hyrjes në fuqi, Ligji nr.133/2015 u ankimua në Gjykatën Kushtetuese, e cila shfuqizoi si antikushtetues nenin 6 pika 3 dhe pika 5 të Ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

Aktualisht Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer procedurën për ndryshimin e VKM nr.222 / 2016.

Gjatë **periudhës 2016 – Nëntor 2017**, Agjencia e Trajtimit të Pronave, nëpërmjet Sektorit të Shqyrtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie ka proceduar me **2667 kthime aktesh** (503 akte janë kthyer gjate vitit 2016 dhe **2164 akte janë** kthyer gjate vitit 2017).

Për pjesën e aplikimeve që plotësojnë kriteret ligjore të VKM-së 222/2016, Agjencia ka kryer kalimin e praktikave në cilësinë e dosjeve, kundra një pagese. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer kalimin e 597 praktikave në cilësinë e dosjeve të reja.

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka trajtuar me vendim 856 (365 dosje për vitin 2017 dhe 491 dosje për vitin 2016).






Të drejtat e fëmijëve

Kuadri ligjor

Nëpërmjet **ligjit nr. 37/2017 është miratuar Kodi i Drejtësisë për të Mitur**, i pari kod i posaçëm për të mitur i hartuar sipas modelit më të mirë ndërkombëtar dhe që mundëson trajtimin e të miturve sipas standardave ndërkombëtare. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë është në proces të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të kodit. Në kuadër të rekomandimeve të raportit progresit është hartuar Projekt-Strategjia e Drejtësisë për të Mitur nga një grup pune i përbërë nga ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë dhe të institucioneve të saj të varësisë, si dhe me mbështetjen e UNICEF. Projekt-Strategjia përfshin objektiva dhe ndërhyrje si në fushën e drejtësisë penale për të mitur, ashtu edhe në drejtim të aksesit të barabartë të fëmijëve në drejtësi. Qëllimi i projekt strategjisë për të miturit 2017-2020 në Republikën e Shqipërisë është promovimi dhe mbrojtja efektive e të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore, si dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat, dëshmitar të veprave penale, të miturit nën moshë për tu ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore administrative apo civile, nëpërmjet implementimit të standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve.

Vizioni i strategjisë është përmirësimi i drejtësisë për të mitur, që garanton një drejtësi miqësore për fëmijë dhe mbrojtjen e interesit të tyre.

Për realizimin e këtij vizioni janë parashikuar pesë objektiva strategjike të nivelit të lartë:

-  Objektivi 1: Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi;
-  Objektivi 2: Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit;
-  Objektivi 3: Parandalimi i ri-përfshirjes në krime të të miturve;
-  Objektivi 4: Riintegrim dhe përfshirje sociale e të miturve në konflikt me ligjin;
-  Objektivi 5: Rritje e kapaciteteve të strukturave të sistemit të drejtësisë për të mitur;

Aktualisht kjo draft strategji është përcjellë për mendim në institucionet e linjës.

Sistemi i burgjeve

Nr. Total i të burgosurve për vitin 2017 ka qenë 5466. Nga këta 2593 janë të paraburgosur ose 47%. Dy kategori të personave me probleme të shëndetit mendor trajtohen në sistemin e burgjeve: a. persona me masë mjekësore "mjekim i detyruar" dhe b. persona të burgosur (dënuar/paraburgosur) me probleme të shëndetit mendor.

- ❖ Numri i personave me masë mjekësore "mjekim i detyruar" është 255, prej të cilëve 236 meshkuj dhe 19 gra.
- ❖ Numri i personave të burgosur me probleme të shëndetit mendor në IEVP është 329.

Në zbatim të adresimit të rekomandimeve të raportit të Komisionit Evropian të vitit 2015 dhe të vitit 2016, *ngritja e një instituti të veçantë për trajtimin e personave me sëmundje mendore në burgje përbën prioritet të veçantë*. Në këtë kuadër janë ndjekur hapat e mëposhtme :

- ✚ Në takimin e Komitetit Kombëtar të Investimeve në takimin e datës 14/02/2017 u miratuan listat e projekteve që do të dorëzohen në raundin e 18-të të WBIF-it (Western Balkans Investment Framework). Në bashkëpunim me ish-Ministrinë e Integritimit, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka hartuar një projekt-fishë për përditësimin e projektit për ndërtimin e spitalit të sëmurëve mendor për të burgosurit, si dhe analizën e koston së përfitimit. Është aplikuar për një grant dhe propozimi është në fazën e shqyrtimit.

Në vijim, në kuadrin e masave afatshkurtra, me vënien në funksion të plotë të burgut të ri në Shkodër, po planifikohet transferimi i personave me masë mjekësore mjekim i detyruar nga IEVP Krujë në IEVP Lezhë, e cila do të ndikojë në përmirësimin e kushteve të trajtimit të kësaj kategorie. Hapja e burgut të Shkodrës do të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e kushteve për trajtimin e personave me liri të kufizuar. Me vendosjen e burgut në Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka planifikuar një numër masash, duke zbatuar disa nga rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës. Qendra paraburgimit dhe burgut Shkodër ka një kapacitet prej 600 të burgosur dhe 180 të paraburgosur. Punimet kanë filluar në vitin 2013 dhe kanë përfunduar në vitin 2017. Projekti është financuar nga BE-ja në vlerën prej 14.3 milion euro, ndërsa qeveria shqiptare ka financuar në kuadër të bashkëfinancimit të këtij projekti, një vlerë prej 4 milion euro. Projekti ka përfunduar me sukses dhe pritet të hapet së shpejti.

Për të lehtësuar qëndrimin e personave me probleme të shëndetit mendor në burgje janë hapur Sektorë të Kujdesit të Veçantë për të sëmurët mendor në 8 IEVP (Durrës, Krujë, Ali Demi, Elbasan, Korçë, Peqin, Jordan Misja, Lezhë).

Një marrëveshje bashkëpunimi është lidhur midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Qendrës "Sole" Nr. 4627/1 datë 01.09.2016 për ofrimin e shërbimeve direkte për gratë dhe vajzat në burgje, duke ofruar mundësinë e punësimit dhe rëndësinë e formimit profesional. Më datë 31 gusht 2017 filloi zbatimi i projektit. Me mbështetjen financiare të qendrës Sole u rikonstruktuan një ambient në burgun e grave i cili do të shërbejë si dyqan për prodhimin e ëmbëlsirave të ndryshme. 8 gra janë në proces trajnimit nga qendra Sole. Pas përfundimit të trajnimit, i cili mendohet të zgjasë një muaj, produktet e grave do të shpërndahen nga qendra

Sole në pasticeri private në mënyrë që të bëhet e mundur shitja e tyre dhe shpërblimi i punës së grave.

Me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian për një periudhë 2 vjeçare (shtator 2015-shtator 2017) u zbatua projekti i binjakëzimit “Për reformën në sistemin e burgjeve dhe shërbimin e provës”, në kuadër të (IPA 2013) me një fond prej 1,000,000 euro. Zbatuesi i palës së projektit nga vendet e BE-së ishte Mbretëria e Bashkuar. Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte: *Forcimi i efikasitetit, llogaridhënies dhe besimit të publikut në Sistemin Penitenciar dhe Shërbimin e Provës në përputhje me acquis të BE-së dhe praktikën më të mirë*. Disa nga arritjet kryesore të projektit përmendim:

- Hartimin e propozimeve për ndryshime dhe shtesa në Ligjin për Policinë e Burgjeve, Ligjin për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe Rregulloren e Përgjithshme e Burgjeve, sipas Acquis të BE-së. Ndryshimet e propozuara lidhen kryesisht me riorganizimin strukturor të DPB-së, ri-konfigurimin e burgjeve, vendosjen e një sistemi për vlerësimin e riskut të burgosurve, si dhe reformimin e gradave dhe sistemit të karrierës për punonjësit e policisë së burgjeve.
- Hartimi i një instrumenti për vlerësimin e riskut që quhet “ADRAM”- Model për vlerësimin e riskut aktual dhe dinamik. Vizioni është që ADRAM do paraqesë një tablo të profilit të sigurisë të gjithë popullsisë së burgjeve, e cila do lehtësojë ri-klasifikimin e të dënuarve në kategoritë e sigurisë.
- Është përfunduar puna për rishikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë, Strategjinë për Drejtësinë për të Mitur dhe është paraqitur një raport me rekomandimet përkatëse për përmirësimin e sistemit të ankesave dhe kërkesave në sistemin e burgjeve.
- Një dokument për strategjinë kundër korrupsionit u hartua nga ekspertët e projektit të binjakëzimit dhe i është paraqitur DPB. Gjithashtu, u punua për hartimin e dokumenteve për matjen e performancës (Objektivat dhe Treguesit Kryesorë të Performancës) dhe e një sistemi të pavarur inspektimi. Ekspertët afat-shkurtër studiuuan dhe rishikuan një model për matjen e performancës në sistemin e burgjeve. Ekspertët hartuan një model për vlerësimin me pikë të treguesve të performancës bazuar në pesë fusha kryesore, si siguria, mjedisi i burgut, efektshmëria e institucionit, ndërveprimi i jashtëm, rehabilitimi.

Gjithashtu referuar sistemit të burgjeve, ju informoj shkurtimisht mbi disa zhvillime të fundit.

Në Tetor 2017 u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Bashkisë së Tiranës. Qëllimi i Marrëveshjes është koordinimi i punës dhe përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi për riintegrimin në komunitetin të personave të privuar nga liria përmes përfshirjes në projekte të ndryshme sociale dhe ofrimit të mundësive për të bashkëpunuar dhe për të përfituar nga shërbimet sociale për grupet vulnerabël, që Bashkia e Tiranës ofron në qendrat e saj sociale, kopshte, shkolla etj. Kjo praktikë e mirë po ndiqet nga institucionet ndëshkuese nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me të njëjtin subjekt, me bashkitë, në nivel lokal.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 9533, datë 13.10.2017 është miratuar “Udhëzuesi për trajtimin psiko-social për të burgosurit që kanë kryer krime seksuale”. Ky dokument ndihmon stafin social dhe nxjerr në pah çështjet kyçe që lidhen me aktet seksuale dhe menaxhimin e të burgosurve të cilët kanë kryer krime seksuale. Ky dokument përmbledh informacionin për specialistët e drejtësisë penale që duan të mësojnë më shumë rreth sulmit

seksual, individëve që kryejnë vepra seksuale dhe rolit që sistemi i burgjeve dhe qytetarët mund të luajnë për t'i mbajtur komunitetet e tyre të sigurta.

Në nëntor 2017 u lançua zbatimi i projektit për "Parandalimin dhe luftimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që çon në terrorizëm VERLT (Faza I)". Ky projekt zbatohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe do të shërbejë për të mbështetur Shqipërinë në krijimin e një baze të fortë për ndërhyrje efektive dhe të bazuar në të drejtat e njeriut që synojnë parandalimin dhe luftimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që çon në terrorizëm, në burgje dhe shërbimin e provës në Shqipëri. Projekti do të përqendrohet në tre komponentë kryesorë të ndërlidhur, duke përfshirë vlerësimin e nevojave, trajnimin e stafit dhe shkëmbimin e informacionit, si dhe ndarjen e praktikave të mira midis autoriteteve shqiptare dhe homologëve ndërkombëtarë dhe rajonalë.